

Konventa Kombëtare për Integrimin European

Newsletter

shkurt - dhjetor 2020



Duke e kuptuar Integrimin në Bashkimin European jo thjesht si një axhendë institucionale, por si një projekt ambicioz zhvillimi i nxitur vazhdimisht nga e gjithë shoqëria; roli i shoqërisë civile dhe qytetarëve të angazhuar aktivisht është kyç për promovimin e vlerave europiane dhe rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik për ndikimin dhe përfitimet e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet legislative kanë lançuar “Konventën për Integrimin European” që prej vitit 2014. Konventa filloi në 2014 në një momentum me rëndësi për vendin tonë pasi sapo kishte marrë statusin kandidat. Gjatë implementimit të Konventës në 2014-2016 u organizuan 16 sesione të Grupeve të Punës dhe 2 sesione plenare fokusuar te integrimi european i vendit duke promovuar bashkëpunimin.

Duke qenë një model unik, i aplikuar fillimisht nga Slovak Foreign Policy Association dhe i zbatuar më pas në vende si Serbia, Mali i Zi, B&H, Maqedonia e Veriut, objektivi i konventës është institucionalizimi i debatit publik në çështje të lidhura me BE-në, mbështetur në bashkëpunimin mes qeverisë, shoqërisë civile dhe bizneseve. Nëpërmjet Konventës synohet rritja e pjesëmarrjes të të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare në formulimin e politikave kombëtare, forcimin e aftësive të ekspertëve në negociimin për integrimin european si dhe krijimi i një kanali të qëndrueshëm dhe interaktiv informimi për publikun e gjerë. Konventa u riaktivizua në 2019, duke ngritur katër Grupe Pune, ku secili përbëhet nga përfaqësues të strukturave qeveritare, si dhe ekspertë nga OJF-të, media, academia dhe sektori privat. Grupet e Punës adresojnë kapitujt më sfidues për procesin e pranimit të Shqipërisë në BE: Grupi i Punës I: [Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore](#); Grupi i Punës II: [Drejtësia, Liria dhe Siguria](#); Grupi i punës III: [Bujqësia dhe Zhvillimi Rural](#); Grupi i Punës IV: [Fondet Strukturore](#)

GP I, Sesioni 1: Ndhima Juridike Falas në Shqipëri - roli dhe kontributi i aktorëve jo-shtetërorë	Faqe 2
GP II, Sesioni 1: Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit (të Rregullt dhe të Parregullt): Sfidat në Monitorimin dhe Përbushjen e Kritereve Ndërkombëtare	Faqe 3
GP III, Sesioni 1: Siguria ushqimore dhe standardet e kërkuara në kuadrin e integritimit european	Faqe 4
GP IV, Sesioni 1: Sfidat e Shqipërisë në lidhje me Kapitullin 22 dhe menaxhimi i fondeve të BE-së	Faqe 5
Call for Registration-Civil Society	Faqe 6

Grupi i Punës I: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore

Sesioni 1: Ndhimja Juridike Falas në Shqipëri - roli dhe kontributi i aktorëve jo-shtetërorë

16 nëntor 2020

Sesioni i parë i Grupit I të Punës Kapitulli 23-Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore i cili u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, u hap nga një fjalim i z. *Gledis Gjipali*, Drejtori Ekzekutiv i EMA: “Shqipëria është në prag të fillimit të negociatave. Kjo do të thotë se nevojitet më shumë angazhim në drejtim të administratës shtetërore, si institucioni kryesor në këtë proces dhe nga të gjithë aktorët.” *Znj. Adea Pirdeni*, Zëvendës Ministre e Drejtësisë, u shpreh se Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për garantimin e zbatimit të ligjit të ndihmës juridike falas dhe për caktimin dhe hartimin e politikave dhe strategjive për këtë ndihmë. Për këtë, në vitin 2019 është krijuar një strukturë si Drejtoria e Ndhimës Ligjore Falas. Aspekte të tjera të funksionit dhe performancës së kësaj Drejtorie u theksuan nga *znj. Patricia Pogaçe* nga Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas. *Zonja Eva*



Kovacechova, avokate dhe ish-drejtoreshë e Qendrës së Ndhimës Juridike në Sllovaki, si eksperte Sllovaqe, reflektoi sfidat kryesore të ndihmës juridike në Sllovaki si dhe rastet e suksesit dhe paraqiti forma të tjera të ndihmës juridike falas në vendin e saj. Në fund, *znj. Evis Fico*, Këshilltare e Ministrit në Ministrinë e Drejtësisë, prezantoi rekomandimet e sugjeruara nga

ky grup pune të cilat, gjatë 4 viteve të mëparshme janë pasqyruar në ndryshime të kornizës legjislative dhe institucionale në lidhje me ndihmën juridike falas. Ajo gjithashtu drejtoi sesionin e pyetjeve dhe diskutimeve me pjesëmarrës nga OSHC-të, klinikat ligjore, universitetet, avokatin e popullit dhe institucione të tjera publike.

Rekomandimet (ekstrakt)

- Bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe OJQ-ve u vlerësua si një hap pozitiv drejt ofrimit të ndihmës juridike falas për grupet në nevojë. Megjithatë, vlerësohet si thelbësore trajnimi i kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në këtë proces.
- Procedura e aplikimit dhe e vlerësimit të çështjes nuk duhet të jetë e gjatë, burokratike dhe dokumentet dhe vërtetimet e kërkuara duhet të jenë të limituara, në mënyrë që të jetë sa më e lehtë për personat e interesuar të kenë qasje nga ky shërbim.
- Vlerësohet si e rëndësishme për Drejtorinë dhe organizatat që ofrojnë ndihmë juridike falas për të bërë një vlerësim vjetor të procesit dhe të punës së tyre në mënyrë që të përmirësohet ky proces.
- Nevojitet një bashkëpunim më i mirë me avokatët, në mënyrë që ata të kenë stimuj për t'u përfshirë në këto shërbime. Nga ana tjetër, avokatët duhet të jenë më të përfshirë dhe më të hapur për t'i ofruar këto shërbime pro bono.
- Nevojitet një fushatë promovuese më agresive e fokusuar jo vetëm dixhitalisht, por edhe duke përdorur media tradicionale dhe mënyra të ndryshme të komunikimit pasi shumica e grupeve të cënueshme nuk kanë qasje në internet.
- Ekziston nevoja për më shumë aktivitete dhe trajnime edhe me një publik të gjerë, për t'i informuar ata në lidhje me këto shërbime, mundësitë dhe mënyrën se si të gjithë ata që janë në nevojë mund të aplikojnë dhe të përfitojnë prej tij.

Grupi i Punës II: Drejtësia, Liria, Siguria

Sesioni 1: Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit (të Rregullt dhe të Parregullt): Sfidat në Monitorimin dhe Përbushjen e Kriteve Ndërkombëtare

28 shkurt 2020

Sesioni i parë i Grupit të Punës II: Kapitulli 24- Drejtësia, Liria, Siguria, organizuar në partneritet me Ministrinë e Brendshme në Shqipëri, adresoi temën e qeverisjes së migracionit të përqendruar në masat që duhen marrë për të përbushur objektivat e vendosura nga Strategjia për Migracionin dhe çështje sfiduese në Shqipëri. *Znj. Rovena Voda*, Zëvendës Ministria e Brendshme në Shqipëri shpjegoi në detaje Strategjinë e re Ndërsektoriale dhe Planin e ri të Veprimit për Migracionin duke vlerësuar miratimin e saj si një sukses thelbësor. *Znj. Petra Achbergerová*, ekspertja sllovaqe, specialiste nga Zyra e Migracionit në Ministrinë e Brendshme Sllovaqe gjithashtu bëri një përjasje të situatës në Sllovakia dhe problemeve me të cilat përballet numri i migrantëve në rritje. Përfaqësues nga Sektori i Migracionit në Ministrinë e Brendshme në Shqipëri patën një pjesëmarrje aktive dhe shpjeguan më tej strategjinë e migracionit. Diskutimet u pasqyruan në një grup rekomandimesh dhe politikash të renditura më poshtë:

Rekomandimet (ekstrakt)

- Në vitet e fundit, është evidentuar se ka një rritje të kërkesave për azil në Shqipëri. Në këtë kontekst, është thelbësore një menaxhim i mirë i situatës dhe marrja parasysh e sfidave të reja që do të vijnë si rezultat i rritjes së fluksit të azilkërkuesve.
- Grupi i Punës vlerësoi si domosdoshmëri ngritjen e qendrave të reja pritëse veçanërisht në jug të vendit (në kufi me Greqinë).
- GP rekomandoi si të rëndësishme mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe informacioneve mbi numrin e emigrantëve shqiptarë
- Bazuar në metodologjitë sllovaqe, GP sugjeroi që aktorët kryesorë përgjegjës për migracionin, të komunikojnë më shumë dhe të jenë transparent me publikun. Një shembull interesant dhe i suksesshëm u sugjerua nga ekspertja sllovaqe ku Ministri i Brendshëm mund të marrë pjesë dhe mund të përfshihet gjatë aktiviteteve kulturore dhe / ose sportive, në mënyrë që të informojë dhe sensibilizojë çështjet që lidhen me migrimin
- është vlerësuar si e rëndësishme përfshirja dhe pjesëmarrja e ekspertëve në shfaqjet televizive dhe diskutimet publike rreth migrimit dhe azilit,
- është i rëndësishëm një autoritet koordinues, i cili do të lehtësonte koordinimin dhe komunikimin ndërmjet institucioneve;
- Të sigurohemi që roli dhe përgjegjësitë e secilit institucion janë të qarta dhe nuk ka mbivendosje ose boshllëqe.
- është rekomanduar që të ketë përpjekje më të hollësishme në lobimin për më shumë fonde dhe mbështetje financiare nga BE kur bëhet fjalë për çështje përfshirë menaxhimin e migracionit
- Në lidhje me procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së, grupi i punës rekomandoi që të merren parasysh këto tre elemente: 1) të merren parasysh veçoritë e institucioneve, historia dhe vlerat, 2) të promovohet bashkëpunimi dhe ndihma me BE-në dhe Shtetet Anëtare.; 3) procesi i harmonizimit duhet të vazhdojë gradualisht
- Sugjerohet një bashkëpunim më i thellë me aktorë të tjerë ndërkombëtarë si IOM ose UNHCR.




Grupi i Punës III: Bujqësia dhe Siguria e Ushqimit

Sesioni 1: Siguria ushqimore dhe standardet e kërkuara në kuadrin e integritit evropian

09 dhjetor 2020

Sesioni i parë i Grupit të Punës III: Kapitulli 11 & 12 -Bujqësia dhe Siguria Ushqimore u



organizua në partneritet me Parlamentin Shqiptar dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE). *Znj. Vasilika Hysi*, Nënkryetare e Parlamentit Shqiptar dhe anëtare e Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian theksoi bashkëpunimin e Parlamentit me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë dhe nevojën për një plan veprimi. *Znj. Elda Zenelaj*, Drejtore e Sekretariatit Teknik të KKIE, bëri një prezantim mbi Këshillin Kombëtar për Integrimin Europian dhe u shpreh se KKIE është i hapur për mundësi për organizimin e aktiviteteve të tjera të ardhshme. *Z. Florian Xhafa*, Ekspert i Brendshëm i Grupit të Punës III, prezantoi pikat kryesore të standardeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe evolucionin e procesit të integritit evropian. *Z. Agim Rrapaj*, Kryetar i Këshillit Shqiptar të Agrobiznesit (KASH), bëri një prezantim në lidhje me çështjet kryesore dhe problematikat në lidhje me këtë fushë veçanërisht për

komunitetin e biznesit. *Z. Matej Struhar*, ekspert sllovak për sigurinë e ushqimit, prezantoi përvojën sllovaqe dhe mësimet që mund të nxirren dhe përdoren në rrugën drejt procesit të integritit evropian. Në fund të sesionit u paraqitën rekomandime të tilla si:

Rekomandimet (ekstrakt)

- Miratimi i legjislacionit shqiptar në harmonizim me atë të BE-së, vlerësohet të ketë shkuar mirë, por problemi kryesor është mënyra e zbatimit të këtij legjislacioni në vend.
- Bashkëpunimi dhe roli i aktorëve të shoqërisë civile duhet të rritet si në informimin dhe monitorimin e procesit të anëtarësimit dhe negociatave në Shqipëri, ashtu edhe në fokusimin në tema dhe kapituj të veçantë si siguria e ushqimit.
- Lidhur me parimin e dytë të rregullimit të higjienës në lidhje me analizën e rrezikut, Shqipëria paraqet probleme pasi edhe sot ende nuk ka një plan analitik për sigurinë e ushqimit.
- Rekomandohet si e rëndësishme hartimi i një ligji gjithëpërfshirës për të lidhur zinxhirët e ndryshëm të sigurisë ushqimore: bujqësia, blegtoaria, peshkimi, industria ushqimore, mjedisi, tregjet agro-blegtoarale dhe mikrofinancimi.
- Informaliteti u theksua si një problem i madh i bizneseve bujqësore, ku nga 354 mijë fermerë vetëm 15% e tyre kanë NIPT. Prandaj, ligji i pa ndryshuar asnjëherë, "Për kooperativat bujqësore" konsiderohet i pazbatueshëm dhe sugjerohet të zëvendësohet me një ligj tjetër.
- Tregjet agro-blegtoarale u konsideruan nga GP III si hallka më e dobët. Duhet bërë më shumë punë për të siguruar që këto tregje të përmbushin standardet e kërkuara.
- Përditësimi i Kodit Penal në vitin 2019 u vlerësua si pozitiv, megjithatë, u konsiderua e rëndësishme të jepeshin rekomandime gjatë fazës së konsultimit publik nga palët e interesuara të përfshira në sigurinë e ushqimit.
- Ekziston nevoja për të hartuar një program specifik të punës për të përmirësuar situatën e sigurisë ushqimore në sektorët e bagëtisë dhe akuakulturës

Grupi i Punës IV

Sesioni 1: Sfidat e Shqipërisë në lidhje me Kapitullin 22 dhe menaxhimi i fondeve të BE-së

23 tetor 2020

Falë përvojës së ekspertëve në vlerësimin e çështjeve që lidhen me procesin e zbatimit dhe menaxhimin e fondeve të BE-së nga Shqipëria, Sesioni 1 i Grupit të Punës IV: Kapitulli 22 (Fondet Strukturore), diskutoi programimin dhe zbatimin e programeve financiare, veçanërisht të përqendruara në Fondet IPA. Pas fjalës hyrëse të z. *Gledis Gjipali*, Drejtori Ekzekutiv i EMA, z. *Ermal Ilirjani*, kreu i Fondit Shqiptar të Zhvillimit (ADF) theksoi që ADF është institucioni i besuar i zhvillimit rajonal i cili ndihmon në nivel qendror dhe lokal për hartimin e dokumenteve të ratifikimit në këtë proces. Për sa i përket fondeve të Bashkimit European, z. *Florian Xhafa*, ekspert i brendshëm i Konventës prezantoi një përmbledhje të Shqipërisë mbi çështjet e zhvillimit rajonal dhe programin e asistencës së BE. Në këtë Sesion, ishte gjithashtu i ftuar eksperti sllovak, z. *Vladimir Benč*, i cili prezantoi një informacion të detajuar në lidhje me Sistemin e Menaxhimit ESIF në Sllovaki si dhe Programin Operacional Rajonal të Integruar 2014-2020 dhe përvojën e tij lidhur me menaxhimin e fondeve të Bashkimit European.


Rekomandimet (ekstrakt)

- Ekziston një nevojë për të modernizuar të gjithë vendin, që do të thotë strukturat e tij fizike, dhe trashëgiminë jomateriale. Administrata publike ka nevojë për të forcuar kapacitetin e saj administrativ.
- Shtetet Anëtare të BE-së mund të mbështesin nëpërmjet asistencës financiare dhe teknike duke përfshirë trajnime, takime të përbashkëta dhe programe; duke synuar forcimin e kapaciteteve institucionale shqiptare në këtë Kapitull.
- Përfshirja e grupeve të interesuara si biznesi, shoqëria civile, organizatat, ekspertët dhe studiuesit në procesin e konsultimit në lidhje me miratimin e IPA III të planifikuar për periudhën 2021-2027, është thelbësore. Nevojiten më shumë informacione dhe hapësirë për kontribut në lidhje me këtë instrument



Rekomandimet (ekstrakt)

- Është thelbësore miratimi i një analize të Mangësive mbi kapacitetet ligjore dhe institucionale.
- Rekomandohet që Shqipëria të hartojë dhe miratojë një politikë strategjike që mbulon këto çështje.
- Roli dhe përgjegjësia e institucioneve duhet të ndahet dhe të jetë shumë e qartë me një organ koordinues të veçantë, në mënyrë që të menaxhojnë fondet në mënyrë efikase.
- Politika rajonale duhet të integrohet me atë ekonomike bazuar në përparësitë afatgjata (gjithashtu nevojitet ekuilibri midis nivelit qendror dhe lokal).
- Sektori privat veçanërisht në sektorin e energjisë, mjedisit, turizmit, bujqësisë duhet të jetë një partner i fortë gjatë gjithë procesit.



Thirrje për Pjesëmarrje: Ekspertë dhe OJF të Shoqërisë Civile

Konventa është e hapur për regjistrime të reja. Ekspertë dhe OJQ janë të ftuar të japin kontributin e tyre në Konventën për Integrimin Europian, si anëtarë të Grupeve të Punës: GP I: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore; GP II: Drejtësia, Liria dhe Siguria; GP III: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; GP IV: Fondet Strukturore.

Pritshmëritë e rezultateve të Grupeve të Punës:

- Rekomandime të politikave nga Sesionet e Grupeve të Punës;
- Hulumtime të përfundimeve nga GP (ekspertët e brendshëm të GP) ;
- Deklarata për shtyp dhe konferenca për shtyp
- Publikime të printuara (rekomandime: Seancat Plenaresë bashku me GP, hulumtimet e ekspertëve të brendshëm);
- Vendosja e bashkëpunimit të rrjetit think-tank lidhur me agjendën e Integritimit Europian me segmente të tjera të shoqërisëEU (qeveri, sipërmarrës, qeveritë vendore, etj...).

Ftohen të gjithë aplikuesit e interesuar të plotësojnë Formularin Online të Regjistrimit dhe ta dërgojnë me e-mail në: info@em-al.org

Formulari i Regjistrimit dhe informacione të tjera lidhur me projektin mund t'i gjeni në portalin online www.eurokoventa.al

